# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-469331**
VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | “Sistemi demokratik ka ndërtuar imunitet ndaj korrupsionit”, Rama: Aeroporti ynë më i madhi në rajon, ia kalon atij të Beogradit |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/politika/sistemi-demokratik-ka-ndertuar-imunitet-ndaj-korrupsionit-rama-aeroport-i588368` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 25 shtator 2026, 15:09:38 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 25 shtator 2026, 15:15:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `70ef9dba3f2feb3980ba06c9f71f4f81690229087ad2c3aa56c8b5244a40582d` |
| TEKSTI | `af158878b6cf4bfaa8487aa765dcae0a49bb7becd86f2051ff69d056e7f0d548` |
| PAMJA | `ec742fbda871e50ee408a03864813827f51fc418da6d148072fd2e715b9d7285` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `2788126855bb3549a21ee25c6476e4e86cfeae373ead63b1738fd5e1cd34e909` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `a8b637500bb34dd44849ee47713c862e0f86b2067940dc4d517e848dfddb5dc3` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/2788126855bb3549a21ee25c6476e4e86cfeae373ead63b1738fd5e1cd34e909`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# “Sistemi demokratik ka ndërtuar imunitet ndaj korrupsionit”, Rama: Aeroporti ynë më i madhi në rajon, ia kalon atij të Beogradit

TemA

25 Shtator 2026, 17:15Politika TEMA



Kryeministri Edi Rama ka deklaruar se Shqipëria ka shënuar ndryshime të rëndësishme në vitet e fundit, duke veçuar zhvillimin ekonomik, rritjen e numrit të udhëtarëve dhe luftën kundër korrupsionit.

Në fjalën e tij në New York, gjatë mbrëmjes gala të organizuar nga Këshilli për Marrëdhëniet Shqiptaro-Amerikane, Rama u ndal te aeroporti i Tiranës, duke theksuar se prej disa vitesh ai ka numrin më të madh të udhëtarëve në rajon.

Kryeministri u shpreh se këto zhvillime nuk janë të lehta për t’u pranuar nga të gjithë, duke theksuar se *“ka forca që nuk kanë qejf të na shohin kështu”.*

Rama foli edhe për luftën kundër korrupsionit, duke deklaruar se ajo duhet të zhvillohet çdo ditë. Sipas Ramës, Shqipëria po hyn në një fazë ku korrupsioni nuk mund të jetë më pjesë e funksionimit të përditshëm të vendit.

*“Është viti i pestë a i gjashtë që kemi aeroportin më të madh në rajon, duke qenë shumë i madh jo vetëm në terma relative, por edhe në shifra absolute, me më shumë udhëtarë se aeroporti i Beogradit, që ka qenë më i madhi në rajon. Kjo nuk është e thjeshtë që ta përtypin të gjithë. Kush është Shqipëria që të rritet dhe të tregojë këtë kapacitet për ndryshim? Ka forca që nuk kanë qejf të na shohin kështu.*

*Nuk po them që nuk kemi probleme. Ne shqiptarët, atë çfarë e shohim si problem, partnerët europianë e shohin si sukses. A mund të ketë një vend më shumë korrupsion në rast se korrupsioni luftohet çdo ditë? Lufta kundër korrupsionit të ndodhë çdo ditë. Jo, nuk është.*

*Sot, sistemi demokratik i Shqipërisë ka nisur të ndërtojë imunitet ndaj korrupsionit. Nuk është fjala thjesht për një udhëheqës apo qeveri, është për një sistem që funksionon, me gjithë nevojën për t’u rritur dhe pjekur më tej. Çdo ditë nuk është më vendi ku mund të ecësh dorë më dorë me korrupsionin.”*

---

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Ndryshime në qeveri, ja kush ikën dhe kush vjen!

17:05 Politika

[“Ky vend e tradhtoi Hashim Thaçin”, Rama nga New York: SHBA nuk bëri më të mirën për George Washington-in e Kosovës]

16:43 Politika / 3 komente

“100 bashki dhe 12 qarqe”, PD depoziton ligjin për ndarjen territoriale të vendit

16:35 Politika / 1 koment



Von der Leyen nis turneun në Ballkan - Presidentja e KE-së mbërrin të mërkurën për takime zyrtare

16:05 Politika / 2 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.